



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 177
Datë: 26/11/2025

Institucioni: Universiteti i Prishtinës

Njësia Akademike: Fakultetin e Edukimit Fizik dhe i Sportit

Programi Studimor: Trajner Sportiv

Niveli i studimeve: MASTER

Numri i ECTS: 60

Pasqyra e perspektivës së studentit për programet studimore të Universitetit të Prishtinës ka për qëllim të reflektojë mundësitë e përgjithshme të punësimit dhe studimeve të mëtejshme pas përfundimit të studimeve. Kjo qasje ndihmon universitetin të theksojë rolin e tij në përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar, të cilët janë të aftë të përmbushin kërkesat e tregut të punës vendor dhe ndërkombëtar

Përspektiva e punësimit për të diplomuarit

Nr.	Titulli i Pozitës së Mundshme	Lloji i Punës / Roli	Sektori i Punësimit në Kosovë	Mundësia për Studime të Mëtejshme
1	Mësimdhënës në shkollat e arsimit parauniversitar	Mësimdhënës i Edukates fizike-sportet dhe shendeti	Sektori i Arsimit Parauniversitar	PhD në Fushën e edukimit fizik dhe sportit
2	Assistent Universitar	Assistent në Fakultetet e edukimit fizik dhe sportit	Sektori i Arsimit Universitar	PhD në Fushën e edukimit fizik dhe sportit
3	Trajner I Sporteve	Trajner në klubet sportive	Sektori privat/OJQ	Studime të mëtejme për Licencime sipas standardeve ndërkombëtare
4	Instruktur në qendrat e Fitnessit	Instruktur përgjithshëm por edhe trajner personal	Sektori privat	Studime të mëtejme dhe specializime për Fitnessin dhe Nutricionin
5	Administrator sportiv	Administrator të sporteve në KOK, Federata sportive	Sektori - OJQ	Kurse të mëtejme dhe specializime për Administrim: 1. Akademia Olimpikë 2. ASMC-KOK 3. Kurse specifike në Federata



• **Programi MASTER “Trajner Sportiv”**

Programi i studimit MASTER “Trajner Sportiv” akumulon gjithsej 60 ECTS gjatë një viti të studimit, të ndara në dy semestra me nga 30 ECTS secili. Ky program është i dizajnuar duke përfshirë fusha studimore tipike për “Trajner Sportiv” dhe mbulohet nga staf akademik i profilizuar për çdo lëndë, përfshirë edhe lëndët e specializuara të fushës, duke u ofruar studentëve njohuri dhe shkathtësi profesionale të nevojshme për zhvillimin e kompetencave pedagogjike, metodike dhe praktike.

Pas përfundimit të këtij programi, studentët e diplomuar fitojnë kompetenca të plota për punësim në arsimin parauniversitar, Institucione, KOK, Federata dhe Klube sportive, si dhe në fusha të tjera që lidhen ngushtë me edukimin fizik dhe sportin, veçanërisht si **Trajner Sportiv**.

Lëndët e këtij programi mbulohen nga **mësimdhënës kompetentë** me thirrje akademike adekuate, përkatëse me ligjëratat që realizojnë. Studimet në këtë program janë **pa pagesë**, ndërsa pas përfundimit të programit MASTER “Trajner Sportiv”, studentët kanë të drejtë ligjore të vazhdojnë studimet në nivelin **PhD**, si dhe të orientohen në **fushën profesionale të trajnerit sportiv**, duke u kualifikuar si **Trajnerë Sportivë profesionistë**.

Ky program studimi ofron një **perspektivë të gjerë punësimi**. Në bazë të **Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës**, miratuar nga **Kuvendi i Republikës së Kosovës më 29 gusht 2011**, dhe në përputhje me **Nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**, në **Nenin 16, pika 5**, thuhet:

“Vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që çojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t’u punësuar në një shkollë.”

Kjo e bën **Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit** institucionin e vetëm të arsimit të lartë që kualifikon mësimdhënës të edukimit fizik dhe sportit, duke e bërë programin me **perspektivë të sigurt dhe të qëndrueshme**.

Faktor shtesë i qëndrueshmërisë së këtij programi është fakti që, përveç formimit si mësimdhënës të edukimit fizik dhe sportit, studentët që ndjekin këtë program kanë mundësi të **profilizohen qartësisht si Trajner Sportiv**, një ndër profesionet më të kërkuara në tregun e punës në **Republikën e Kosovës**.